



An EU funded project

EU Trade
Policy Project



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

Përmbledhje e Shkurtër mbi Tregtinë

Tregtia në Shërbime

Janar 2015

Mbështetur nga:

Këtë publikim e mbështet projekti i
BE-së "Asistencë Teknike
Zhvillimit të Mëtutjeshëm të
Politikës Tregtare të Kosovës"



**EU Trade
Policy Project**



implemented by:



Përgatitur nga:

Sytrime Dervisholli
Mirsad Simnica
Artan Xërxa

Mohim:

Këtë publikim e ka nxjerrë
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
(MTI). Përmbajtja e këtij publikimi
është përgjegjësi e vetme e MTI-së
dhe në asnjë mënyrë nuk mund të
konsiderohet se paraqet pikëpamjet
e mbështetësit.

Publikuar nga:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Rr. Muharrem Fejza
p.n. Lagja e Spitalit
10 000 Prishtinë
Republika e Kosovës



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry

HYRJJE

Kjo përmbledhje e shkurtër paraqet përshkrimin e eksporteve të shërbimeve në Kosovë. Ky punim dëshmon se sektori ka funksionuar jashtëzakonisht mirë në dekadën e fundit ose më shumë, sidomos në lidhje me eksportet e mallrave dhe ka mundësi të madhe për zgjerim të mëtejshëm. Regjimi i tregtisë së shërbimeve të Kosovës është mjaft liberal, megjithëse, për ofruesit e shërbimeve, është mjaft e kufizuar qasja në tregjet tjera më të gjera dhe rajonale. Për këtë arsye, Kosova është përfshirë në negocimin e liberalizimit të shërbimeve, së pari, me vendet fqinje në kuadër të CEFTA-së, dhe së dyti, me BE-në në kornizën e MSA-së. Negociatat do të hapin mundësi për tregje të reja, të cilat do t'i japin sektorit një stimul shtesë.

1. PASQYRA E TREGTISË SË SHËRBIMEVE NË KOSOVË

Eksportet e shërbimeve janë kontribues i rëndësishëm në ekonominë e Kosovës; Kosova është eksportues neto i shërbimeve. Në dekadën e fundit, eksporti i shërbimeve ka qenë shumë më i lartë se importi dhe në disa vite dallimi ishte dyfishi i importeve (shih tabelën në vijim). Midis viteve 2005 dhe 2013 Kosova ka eksportuar mbi €4 miliard në shërbime, ndërsa bilanci pozitiv tregtar arriti në €1.6 miliard. Mesatarisht, në të njëjtën periudhë, eksportet e shërbimeve të Kosovës ishin rreth €500 milion, ndërsa importet mesatare të shërbimeve ishin rreth €300 milion. Realizimi ndërkombëtar i shërbimeve ishte veçanërisht i mirë në disa nga vitet e fundit; në vitin 2012 eksportet e shërbimeve arritën kulminacionin në Kosovën e pasluftës, me €635 milion, ndërsa në vitin 2013, eksportet e shërbimeve të Kosovës arritën në €622 milion. Në përgjithësi, sipas Bankës Qendrore të Kosovës, në vitin 2013 eksporti i shërbimeve ka përfaqësuar rreth 10% të PBB-së, ndërsa importet llogariten rreth 7,5% të GDP-së.

TREGTIA E SHËRBIMEVE TË KOSOVËS, € MIL., 2005-2013

Viti	Eksportet	Importet	Bilanci
2010	573.0	386.1	186.9
2011	618.5	352.8	265.7
2012	635.1	288.8	346.2
2013	622.0	313.7	308.4
Totali, 2005-2013	4,312.5	2,690.1	1,622.4
Mesatarja, 2005-2013	479.2	298.9	180.3

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (<http://bqk-kos.org/repository/docs>)

Dy kontribuesit kryesor në eksportin e shërbimeve ishin sektori i udhëtimeve me mbi €400 milion dhe ai i komunikimit, përfshirë TKI, me gati €60 milion (shih tabelën në vijim). I mëparshmi kryesisht lidhet me fluksin e Diasporës së Kosovës. Sipas Bankës Qendrore të

Kosovës, tendenca pozitive po vazhdon; në gjashtë muajt e parë të vitit 2014 (të dhënat paraprake) eksportet e shërbimeve përbënin €291.7 milion, krahasuar me vitin 2013, ku shërbimet kishin arritur në €257 milion. Megjithatë, këta sektorë kyç, dmth. i udhëtimit dhe ai i komunikimit, janë kontribuesit kryesor me 13 për qind të totalit në rastin e të mëparshmit, ndërsa shërbimet e komunikimit dhe TKI kanë kontribuar me 15 për qind në totalin e eksporteve të shërbimeve.

SEKTORËT KRYESOR TË SHËRBIMEVE NË KOSOVË, € MIL., 2013

Sektorët	Eksportet	Importet	Bilanci
Udhëtimet	406.	100.6	306.0
Komunikimi	56.8	23.7	33.1
Ndërtimtaria	9.4	2.9	6.5
Shërbimet tjera	44.3	40.6	3.6
Sigurimi	22.7	32.1	-9.4
Financiare	1.8	2.7	-0.8

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (<http://bqk-kos.org/repository/docs>)

2. TREGTIA E SHËRBIMEVE, OBT DHE GATS

Me Marrëveshjen e Përgjithshme mbi Tregtinë e Shërbimeve (GATS), Organizata Botërore e Tregtisë (OBT) ka krijuar një nomenklaturë të veçantë për të llogaritur eksportet e shërbimeve. Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve korrespondon me një transaksion i cili ndodh mes një prodhuesi dhe konsumatori të bazuar ligjërisht në vende të ndryshme ose territore doganore, duke përdorur mënyra të ndryshme të ofertës (shih tabelën në vijim për detaje) si për eksport, ashtu edhe import të shërbimeve.

TREGTIA E SHËRBIMEVE – KATËR MËNYRAT E OFERTËS

Mënyra 1 – Oferta Ndër-Kufitare: transaksioni ndodhë përtej kufirit pa lëvizje të ofruesit ose shfrytëzuesit. Kjo mënyrë kryesisht zhvillohet me tregti elektronike ose me internet. Shembujt: konsulenca ose raportet e hulumtimit të tregut, këshilla tele-medicinale, trajnimi në distancë, etj.	Mënyra 2 – Konsumi Jashtë Shtetit: konsumatori i vendit A shkon në vendin B dhe paguan për një shërbim që e merr. Shembujt: pushimet në Shqipëri ose Turqi; arsimimi në universitetet jashtë shtetit, etj.
Mënyra 3 – Prania komerciale: Një ofrues i shërbimeve ka themeluar filialin, zyrën ose degën e tij aty ku gjendet konsumatori.	Mënyra 4 – Prania e Personave Fizik: Profesionistët e huaj të cilët u ofrojnë shërbime konsumatorëve në vendin amë

Shembujt: filialet ose degët e bankave të huaja, kompanitë e telekomunikacionit, etj.

Shembujt: mjekët, kontabilistët, juristët, të cilët punojnë në vendet e jashtme, etj.

Burimi: Web faqja e OBT (www.wto.org)

GATS-i – është marrëveshja mbi tregtinë multilaterale në kuadër të OBT-së, e negociuar gjatë Raundit të Uruguait dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1995. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje mbi tregtinë e shërbimeve multilaterale ishte të krijohej një sistem i sigurt i rregullave të tregtisë ndërkombëtare, për të siguruar transparencë të regjimeve kombëtare tregtare, trajtim të drejtë dhe të barabartë të të gjithë pjesëmarrësve, për të promovuar tregtinë dhe, si rezultat, të stimulohet rritja dhe zhvillimi ekonomik me liberalizim gradual të tregtisë. Kosova, në aspiratat e saj të ardhshme për t'u bërë anëtare e OBT-së do të duhet të respektoj dispozitat e GATS-it, e cila është kornizë globale, që e rregullon tregtinë e shërbimeve.

3. PËRFITIMET DHE SFIDAT E LIBERALIZIMIT TË TREGTISË SË SHËRBIMEVE

Për sa i përket punësimit dhe prodhimit, shërbimet po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për rritjen ekonomike. Kosova mund të përfitojë nga liberalizimi i shërbimeve nëse ajo e rrit konkurrencën nga ana e ofertës (zgjedhje shtesë e ofruesve të shërbimeve). Aktualisht, Kosova ka një regjim mjaft liberal të tregtisë së shërbimeve. Megjithatë, mbizotërojnë pengesat për ofruesit e shërbimeve të Kosovës për të hyrë në tregjet tjera, veçanërisht ato rajonale dhe tregjet më të gjera evropiane. Përmes marrëveshjeve bilaterale dhe rajonale, kompanitë dhe individët e Kosovës do të përfitojnë nga qasja në tregje të ndryshme të reja në kuadër të CEFTA-s dhe vendeve të BE-së, edhe pse, kjo kushtëzohet nga niveli i konkurrueshmërisë dhe cilësia e shërbimeve të kryera nga ofruesit e shërbimeve nga Kosova.

Heqja e kufizimeve me Njohjen Reciproke të Kualifikimeve (NRK) për qasje në treg nga vendet e tjera, veçanërisht vendet e CEFTA-s, do t'u mundësojë inxhinierëve, avokatëve, kontabilistëve, mjekëve, arkitektëve dhe shumë profesionistëve tjerë të Kosovës të kryejnë shërbimet e tyre në rajon dhe të zhvillojnë aftësi të reja. Krijimi i një tregu më të madh shpesh do të përmirësojë cilësinë e shërbimeve, do të ul çmimet dhe në këtë mënyrë do të rrit konkurrencën. Sa i përket punësimit, ai do të krijoj më shumë vende pune, duke përvetësuar aftësi dhe teknologji më të mira dhe të reja.


Aktualisht, Kosova është përfshirë në diskutimet për liberalizim të mundshëm të shërbimeve profesionale dhe të bizneseve me anëtarët e CEFTA-së.

Sipas kornizës së MSA-së, negociatat përfshijnë të drejtën për të ndërmarrë veprimtari të lidhura me tregti, për prani komerciale dhe prani të personave fizik.

Në rastin e Kosovës, përparësia e liberalizimit të tregtisë së shërbimeve brenda kornizës së CEFTA-së dhe MSA-së ka të bëjë me:

- Lidhjen e nivelit aktual të liberalizimit të regjimit të tregtisë së shërbimeve të Kosovës me palët tjera kontraktuese;
- Krijimin e qasjes në treg të ri për kompanitë dhe individët; tregjet e huaja do të mund të depërtoheshin më lehtë dhe me kosto më të ulët;
- Shtimin e transparencës dhe parashikueshmërisë së regjimit të politikave tregtare të Kosovës dhe palëve tjera kontraktuese;
- Nxitjen e ofruesve vendor të shërbimeve të rrisin konkurrueshmërinë në krahasim me ofruesit e shërbimeve nga pala tjetër kontraktuese (ulja e kostos, modernizimi i objekteve, përmirësimi i shërbimeve, zgjidhja superiore e shërbimeve, shërbimet cilësore, etj.)
- Uljen e çmimeve për shërbime të ndryshme në treg si rezultat i efektit të konkurrencës;
- Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që u ofrohen qytetarëve të Kosovës dhe qytetarëve të vendit-eve negociuese.

Mirëpo, procesi i liberalizimit të shërbimeve është shpesh sfidues, sepse Kosova do të mund të përballë me shumë pengesa gjatë procesit të negociatave. Njëra nga sfidat kryesore është plani i zotimeve ku një vend duhet të jetë shumë i kujdesshëm për çka të zotohet dhe si do të ndikojë ajo në sektorë të veçantë dhe në cilin nivel. Grafiku në vijim përshkruan shtyllat kryesore të procesit të negociatave në zhvillim e sipër:



KONKLUZIONI

Eksportet e shërbimeve kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës, kryesisht me mbylljen e hendekut të madh të lënë nga niveli i ulët i eksporteve të mallrave. Sektorët e shërbimeve, veçanërisht sektori i udhëtimeve dhe komunikimit, kanë funksionuar jashtëzakonisht mirë. Në bazë të provave të paraqitura, shërbimet kanë kontribuar në reduktimin e problemeve tjera strukturore në ekonominë e Kosovës, veçanërisht papunësisë. Megjithatë, tendencat tregojnë se mundësia për t'u rritur shërbimet është edhe më e lartë. Qeveria e Kosovës, përmes kornizës së CEFTA-s dhe MSA-së, po ndërmerr hapa të menduar për t'ua lehtësuar ofruesve të shërbimeve qasjen në treg në vendet fqinje dhe në BE. Liberalizimi i shërbimeve ka gjasa të gjenerojë përfitime të mëtejshme për ekonominë e Kosovës si njohja reciproke e kualifikimeve, e cila mundëson lëvizjen e lirë të personave për të ofruar shërbime jashtë vendit. Megjithatë, Qeveria e Kosovës gjithashtu e di se për t'u shtuar këto përfitime të gjera, duhet të ndërmerren hapa tjerë të politikave, përfshirë ndër të tjera, edhe përmirësimin e klimës së biznesit, avancimin e aftësive të fuqisë punëtore, dhe qasjen më të lehtë në teknologji dhe informacione.